

## KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me date 20.07.2021

- **SHITËSI - Z. Herald Dyla**, shtetas shqiptare, lindur me 30/10/1988, në Kavaje, Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me dokument identifikimi, **Nr. I81030074T**.
- **BLERESI - Znj. Rafaela Pitika**, shtetas hellenic, lindur me 28/01/2001, në Nikaia, Greqi, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me dokument identifikimi, **Nr. AT1048991**.

### **BAZA LIGJORE**

#### **Referuar dispozitave ligjore**

- Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”
- Ligji Nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” me ndryshimet e mëvonshme
- Kodi Civil
- Akti i Themelimit e Statuti i Shoqërisë
- Data e rregjistrimit është 12/04/2021

### **OBJEKTI**

Mbi bazën e ekstraktit të **Shoqërisë “Aspero trading” sh.p.k, shitesi Z. Herald Dyla, është ortaku i cili gezon 100,00% ta kapitalit të shoqërisë me numer pjesesh 1,00 dhe vlere kapitali 100.000,00**

Mbi bazën e dokumentave të sipërcituar, përpilojmë këtë kontratë shitje kuotash me objekt:

- **Shitesi** i shet blerësit 100% të kuotave që zotëron në **Shoqërine “Aspero trading” sh.p.k**, kundrejt vlerës totale Leke (njqind mije leke), likuidimi i së cilës do të realizohet në rrugët e parashikuara në ligj në një moment të dytë pas nënshkrimit të kësaj kontrate që do të përcaktohet me mirëkuptim. Në momentin e nënshkrimit të Kontrates Pala blerëse merr persiper të gjithë detyrimet që ka pala shitëse ndaj institucioneve shtetërore ose ndaj institucioneve private ose individeve . Palët bien dakort që ky ndryshim të pasqyrohet në QKB pasi kontrata e shitjes se kuotave të regjistrohet në QKB.

Me hartimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate **Z. Herald Dyla** zhvishet nga pronësia si dhe detyrimeve ndaj institucioneve shtetërore ose ndaj institucioneve private ose individeve dhe deklaron se heq dorë nga çdo e drejtë për të kërkuar përfitime të çdo lloji për këtë sasi kuotash, po

kështu heq dorë përfundimisht nga çdo pretendim mbi dividendet dhe çdo përfitim tjetër nga aktiviteti i shoqërisë në një masë prej 100 % duke pranuar këtë transaksion.

Ndarje e re e dividendit do të bëhet në masën 100 % per **Znj. Rafaela Pitika, e cila do te jete Ortake dhe Administratore e Veteme e shoqerise "Aspero traiding" shpk.**

- Mbas nënshkrimit të këtij Akti e pasqyrimit të QKB Shoqëria pëson këto ndryshime:

**Ishte:**


Shoqëria "**Aspero traiding**" sh.p.k me Ortakë: **Z. Herald Dyla** eshte zotësues i 100% të kapitalit në Shoqërisë "**Aspero traiding**" sh.p.k.

**Bëhet:**

Në bazë të vendimit, Ortak dhe Administrator i vetem "**Aspero traiding**" sh.p.k do te behet **Znj. Rafaela Pitika**, shtetas hellenic, lindur me 28/01/2001, në Nikaia, Greqi, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me dokument identifikimi, **Nr. AT1048991** me 100% te kapitalit te Shoqerise me vlere nominale te barabarte me 100.000,00 Leke.

**SHITËSI**

**Herald Dyla**



**BLERËSI**

**Rafaela Pitika**

Rafaela Pitika